

Në bazë të nenit 55 alineja 1 i Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 i Ligjit për arsim fillor („ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. бр. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 и 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1, alineja 4 i Ligjit për Byronë për zhvillimin e arsimit (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi Programin mësimorë për lëndën e matematikës për klasën e I të arsimit fillorë

Cambridge International Examination
Byroja për zhvillimin e arsimit

PROGRAMI MËSIMOR
MATEMATIKË
për klasën e I

në arsimin fillor nëntëvjeçar

Shkup, shkurt 2014

Hyrja

Programi mësimor për matematikë për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçarë është marrë prej Qendrës ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination) dhe e përshtatur (adoptuar) nga Byroja për zhvillimin e arsimit.

Miratimi i përshtatjes së programit mësimor është lejuar nga ekspertë të Qendrës ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination).

Programi mësimor përmban përmbledhje të qëllimeve mësimore zhvillimore të lëndës mësimore të matematikës. Në ato në mënyrë të detajuar përshkruhet çka nxënësi duhet të di ose çka duhet të mundet të bëjë në çdo vit të arsimit fillor.

Qëllimet mësimore sigurojnë strukturë për mësimdhënie dhe të mësuarit si dhe udhëzime për atë se cilat shkathtësi dhe dituri të nxënësit mund të vërtetohen.

Programi mësimor për matematikë është i ndarë në pesë fusha(lëmi): Numrat/Operacionet matematikore, Gjeometri, Matje, Punë me të dhëna dhe zgjidhje të problemeve. Katër fushat e para janë të mbuluara(përfshira) në fushën Zgjidhje të problemeve, në të cilën janë të përshkruara teknikat, shkathtësitë dhe zbatimi i diturive si dhe strategjitë në zgjidhjen e problemeve. Strategjitë e të menduarit po ashtu janë pjesë kryesore në fushën (lëminë) Numrat. Ky program mësimor fokusohet në parime (principe) skema, sisteme, funksione dhe relacione ashtu që nxënësit të mund ti zbatojnë dituritë matematikore dhe të zhvillojnë të kuptuarit holistik për lëndën.

Programi mësimor për matematikë për klasën e parë në arsimin fillor na jep bazë të theksuar(solide) nga e cila mund të përsosen(zhvillohen) fazat e mëtutjeshme të arsimit.

Programi mësimor realizohet me fond prej 5 orë në javë, gjegjësisht 180 orë në vit.

Programi mësimor i Kembrixhit është ndërtuar në bazë të vlerave të Kembrixhit dhe praktikës më të mirë nëpër shkolla. Ai është i përkushtuar kah qëllimi që të zhvillohen nxënës që do të bëhen të përgjegjshëm, inovativ dhe të angazhuar në një mësim aktiv dhe kreativ.

Pjesët e programit që kanë të bëjnë me notimin, kushtet hapësinore për realizimin e mësimin dhe normativit për kuadër arsimor janë dhënë në përputhje me nenin 25, paragrafit 5 të Ligjit për arsim fillor.

Programi mësimor për klasën e parë

1. Temat dhe rezultatet e pritura

Numri

Numrat dhe sistemi i numrave

- Tregon numra sipas radhës (nga 1 deri më 100, nga mbrapa prej 20 deri më 0).
- Fillon të shkruajë shifra prej 0 deri në 9.
- Lexon dhe fillon të shkruajë numra prej 0 deri më 20.
- Numëron gjësende deri në 20 e lidh sasinë me numrin përkatës.
- Numëron nga dhjetë prej zeros deri në 100 (për shembull 10,20,30,.....100)
- Numëron nga dhjetë deri 100 ose diç më shumë se 100, duke filluar nga numri konkret njëshifror .
- Numëron nga dy , fillon të njohë numrat çift dhe tek deri në 20 (psh. 2,4,6 ,.... ose 1,3,5,....)
- Fillon ti zbërthen numrat dyshifror në dhjetëshe dhe njëshe dhe anasjelltas.
- Tregon cili numër është për 1 ose për 10 më i madh ose më i vogël prej cilit do qoftë numri të dhënë prej 0 deri në 30.
- Shfrytëzon nocionet „ më i madh,, ose „ më i vogël,, për të krahasuar dy numra deri në 30 dhe e tregon numrin që gjendet mes tyre.
- Shfrytëzon nocionet „ më shumë,, ose „ më pak,, për të krahasuar gjësendet e grupuara deri më 30.
- Radhitë numrat në varg më së paku deri më 20.
- E shfrytëzon shenjën „ = „, për të treguar njëllojshmërinë (barazimin)
- Bën vlerësim të arsyeshëm për disa gjësende që mundet të vërtetohen me numërim deri më 30.
- I dallon gjysmat e numrave çift deri në 10, përgjysmon forma me palosje dhe i dallon cilat forma janë të përgjysmuara.

Operacionet matematikore

Strategjitë e të menduarit

- I din të gjithë numrat çift me të cilat me cilat fitohet shuma 10 dhe bën lidhshmërinë me mbledhje/ zbritje.
- Fillon t'i mësojë çiftet e numrave shuma e të cilave është 6, 7,8,9,10.
- Mbledh tre numra njëshifror , ku shuma e dy prej tyre është 10, psh. $4 + 3 + 6 = 10 + 3$.

- Fillon të përdorë çifte (grupe) të numrave shuma e të cilave është 10 për mbledhje/zbritje me kalim deri 20 (psh. për të mbledhë $8 + 3$, numrit 8 ja shton 2, pastaj e shton numrin 1).
- Mbledh mbledhës të njëjtë deri më pak $5+5$.
- E shfrytëzon diturinë për mbledhje të çifteve (grupeve) të mbledhësve të njëjtë, gjatë mbledhjes së mbledhësve të ndryshëm psh. $5 + 6$.
- Fillon të numërojë nga 2 dhe nga 10.

Mbledhje/zbritje

- E kupton mbledhjen si numërim përpara dhe kombinimin e dy sasive, e dallon mbledhjen në situata konkrete.
- E kupton zbritjen si numërim mbrapa dhe marrje të një sasive nga tjetra, e dallon zbritjen në situata konkrete.
- E kupton ndryshimin nëpërmjet mbledhjes (edhe sa duhet deri.....?).
- Mbledh/ zbrit numra njëshifror me numërim përpara / mbrapa.
- Gjen për dy më shumë ose për 2 më pak prej numrit 1 deri më 20, duke i vërejtur kërcimet në vargun e numrave.
- E lidh numërimin përpara dhe mbrapa nga dhjetë për të gjetur numra të cilët janë për 10 më të mëdhenj/më të vegjël prej një numri (deri 100)
- Fillon t'i dallojë shenjat „+”, „-”, dhe „=”, në shprehjet matematikore.
- Kupton se ndërimi i radhitjes së mbledhësve nuk e ndryshon shumën.
- Mbledh çifte (grupe) numrash deri 20, duke filluar nga numri më i madh me vazhdim.
- E dallon përdorimin e “shenjës në vend të numrit të panjohur”
 - $6 + \square = 10$; $10 - \square = 6$ gjatë mbledhje/zbritjes
- Fillon të mbledhë numër njëshifror me numër njëshifror dhe numër dyshifror me numër njëshifror deri në 20.

Shumëzimi dhe zbritja me dyfishim dhe përgjysmim

- Dyfishon çfarëdo numër njëshifror.
- Gjen gjysmën prej numrit çift të sendeve deri në 10.
- Përpiqet të ndajë numra deri në 10 që të vërtetojë cilët numra janë çift, e cilat tek.
- Ndanë sende në dy grupe të njëjta.

Gjeometria

Forma dhe të menduarit gjeometrik

- Emëron dhe i ndanë format e thjeshta 2 D (psh. Rrathë, katrorë, kënddrejtë dhe trekëndësha) duke i dalluar sipas numrit të faqeve , sipas vijave të drejta dhe të lakuara . I shfrytëzon që të bë skema dhe modele)
- E dallon vijën themelore të simetrisë.
- I thotë dhe i dallon format e thjeshta 3D (psh. katror, kuadër, cilindër, kon dhe top) duke i dalluar sipas numrit të sipërfaqeve dhe sipërfaqeve të rrafshëta dhe të lakuara. I shfrytëzon për të bë skema dhe modele.

Pozita dhe lëvizja

- Shfrytëzon shprehje të rëndomta për drejtim dhe largësi, për t'i përshkruar lëvizjet e gjësendeve.

Matje

Paratë

- I dallon të gjitha monedhat.
- Llogaritë si duhet të paguhet shuma e duhur me shfrytëzim të monedhave më të vogla.

Gjatësia , masa,vëllimi.

- Krahason gjatësi dhe pesha me krahasim direkt, pastaj me shfrytëzim të njësive jostandarde të rëndomta.
- E vlerëson dhe e krahason vëllimin me krahasim direkt, pastaj me shfrytëzim të njësive jostandarde të rëndomta.
- Shfrytëzon gjuhë krahasuese, psh. më e gjatë, më e shkurtë, më e rëndë, më e lehtë.

Koha

- Fillon t'i kuptojë dhe të përdorë njësi të caktuara për kohën , psh. minutë .orë, ditë, javë,muaj dhe vite.
- E lexon kohën (orën) dhe i njeh pjesët e ndryshme të ditës.
- I radhitë ditët e javës dhe ndodhi të ndryshme të njohura.

Punë me të dhëna

- *Organizimi, kategorizimi dhe paraqitja e të dhënave*

Përgjigjet në pyetje me diferencim dhe organizim të të dhënave ose sendeve në mënyra të ndryshme, psh.

- me shfrytëzim të grafikoneve dhe piktogrameve me mjete praktike;
- bisedë për rezultatet e paraqitura në lista apo tabela me mjete praktike;
- bisedë për rezultatet në diagramin e Venit dhe të Kerolovit duke dhënë kriteret e ndryshme për grupimin e sendeve të njëjta.

Zgjedhja e problemeve

- *Shfrytëzimi i teknikave dhe shkathtësive në zgjedhjen e problemeve matematikore*
- Zgjedh dhe shfrytëzon strategji përkatëse për të llogaritur dhe e shpjegon procedurën.
- Zbatimi i njohurive në zgjedhjen e problemeve me numra dhe bashkimi e pjesëve në një tërësi (.
- Gjen më shumë kombinime, psh. në sa mënyra mundet të radhiten tre sende të ndryshme.
- Vendos a do të përdor mbledhje ose zbritje për ta zgjedhë një problem të thjeshtë të shprehur gojarisht dhe e paraqet duke shfrytëzuar sende.
- E kontrollon përgjigjen me mbledhjen e numrave sipas radhitjeve të ndryshme.
- E kontrollon përgjigjen në detyrën nga zbritja, me mbledhje të përgjigjes dhe numrit më të vogël.
- E shpjegon dhe e vazhdon radhën si që është numërim me nga dhjetë përpara dhe pas, psh. 90, 80, 70.
- I dallon marrëdhëniet e rëndomta ndërmjet numrave, psh. ky numër është për dhjetë më i madh se ai numër.
- I dallon marrëdhëniet e rëndomta ndërmjet formave, psh. ky top është më i vogël se ai.
- Bën vlerësim të kuptueshëm të llogarisë dhe e kontrollon atë.

2. Qëllimet konkrete, aktivitetet dhe mjetet për punë

Temat nga programi mësimor janë dhënë me shembuj të aktiviteteve nëpërmjet të cilave mund të arrihen qëllimet, po ashtu edhe materialet e duhura për realizimin e tyre. Çdo temë realizohet gradualisht dhe në mënyrë zhvillimore në tri periudha gjatë vitit shkollor (1A, 2A, 3A, 1B, 2B, 3B, 1C, 2C, 3C) për shkak të qasjes spirale në planifikim dhe realizimit të mësimdhënies në matematikë. Qasja spirale në procesin e mësimin mundëson të fillohet me atë që nxënësit e kanë të njohur dhe gradualisht të thellohen dhe të zgjerohen njohuritë e nxënësve.

Periudha I	Periudha 2	Periudha 3
1A Numri dhe zgjidhja e problemeve	2A Numri dhe zgjidhja e problemeve	3 A Numri dhe zgjidhja e problemeve
1B Gjeometria dhe zgjidhja e problemeve	2B Punë me të dhëna dhe zgjidhja e problemeve	3B Punë me të dhëna dhe zgjidhja e problemeve
1C Matja dhe zgjidhja e problemeve	2C Matja dhe zgjidhja e problemeve	3 C Matja dhe zgjidhja e problemeve

1 A Numri dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Numrat dhe sistemi i numrave</p> <p>Tregon numra sipas radhës (prej 1 deri 100, mbrapa prej 20 deri në 0)</p> <p>Numëron sende deri në 20 dhe e ndërlidhë sasinë me numrin përkatës.</p>	<p>Nxënësit në klasë numërojnë deri 20.</p> <p>Numërim të sendeve deri 20, ndërlidh me numër përkatës dhe i kontrollon.</p>	<p>Vargje numrash ose tabela qindëshe me numra për verifikim.</p> <p>Sende për numërim: kuti, enë, lodra, letra (karta) me shifra të shkruara deri 20 dhe manipulative tjera që do të ndihmojnë në numërim, numra në radhë, rrjeta ose tabela qindëshe.</p>	
<p>Fillon të shkruaj shifra prej 0 deri me 9.</p>	<p>Shkruan me gisht në ajër, në miell, borë e tjera.</p> <p>Vizatim i shifrave në letër ose kompjuter.</p>	<p>Miell, rërë, borë, letër, kompjuter etj.</p>	
<p>Lexon dhe fillon të shkruajë numra prej 0 deri në 20.</p>	<p>Duhet tu jepni nxënësve numër më të vogël se 20. Kërkoni prej tyre ta vazhdojnë radhën gojarisht dhe me shkrim.</p>	<p>Letër, vargje pa numra (me ruaza, makarona etj.)</p> <p>Tabela qindëshe, vargje me numra të shkruar (për ndihmë)</p>	
<p>Përdorë shprehjet “” më i madh” ose “më i vogël” për të krahasuar dy numra deri në 30 dhe e tregon numrin që gjendet mes tyre.</p>	<p>Numërim me ndihmën e vargjeve numrash, me fotografi si tregues si dhe numra.</p>	<p>Vargje numrash dhe numra</p>	<p>Arsimtari shfrytëzon mjete vizuale për të vërtetuar numrin më të madh dhe më të vogël që gjendet në mes tyre</p>
<p>Shfrytëzon termet “më shumë</p>			<p>Arsimtari shfrytëzon mjete</p>

“ose “më pak” për të krahasuar grupe të sendeve deri 30.	Numërim dhe krahasim të grupeve me sende.		vizuale për të vërtetuar më shumë ose më pak.
--	---	--	---

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialt)	Komentet
<p>Në vargun e numrave ,radhitë numra ,minimum 20.</p> <p>Strategjitë mendore</p> <p>I din të gjithë grupet e numrave shuma e të cilëve është 10 dhe i ndërlidhë me mbledhje/ zbritjen.</p> <p>Fillon ti mëson ti mëson grupet e numrave shuma e të cilëve është 6,7,8,9dhe 10.</p> <p>Bën mbledhje me mbledhës të njëjtë deri në minimum 5+5.</p> <p>Fillon të numëron nga 2 dhe nga 10.</p> <p>Numëron nga dhjetë deri në 100</p>	<p>Punë me të gjithë nxënësit ose punë në grupe. Zgjedhet një letër (kartë) me një numër, fshihet dhe jepen udhëzime për ta gjetur numrin e shënuar në kartë.</p> <p>Numërim i enëve.</p> <p>Numërim i enëve.</p> <p>Numërim i enëve.</p> <p>Shfrytëzimi i duarve dhe shputave (këmbëve).</p> <p>Njoftimi me tabelën qindëshe.</p>	<p>Letra (karta) me numra, vargje numrash dhe rrjete.</p> <p>Numëratore (zhetonë) Enë të vogla, letra me numra 0-10</p> <p>Numëratore (zhetonë) Enë të vogla, letra me numra 0-10</p> <p>Numëratore (zhetonë) enë të vogla, letra me numra 0-10, nga dy letra për çdo numër.</p> <p>Tabela 100 – e madhe Tabela 100 - e vogël për çdo nxënës.</p>	<p>Zhvillim i përfytyrimeve lidhur me numrat e vegjël.</p> <p>Zgjerimi i aktivitetit paraprak, vetëm me ndryshim të një rregulle.</p> <p>Përdorimi i mjeteve të njohura , materialeve dhe aktiviteteve duke e ndryshuar kontekstin . Nxënësit janë të kyçur në mënyrë aktive.</p> <p>Nxënësve duhet tu jepet kohë që të njihen me tabelën 100.</p>

ose diçka mbi 100 duke filluar nga numër konkret njëshifror.			
--	--	--	--

Qëllimet e të mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Numëron nga dy, fillon të dallojë numrat çift dhe tek deri 20.(psh. 2,4,6,.....ose 1,3. 5,...).</p> <p>Bën vlerësim real për disa gjëra të cilat mundet të verifikohen me numërim deri në 30.</p> <p>Mbledhje dhe zbritje E kupton mbledhjen si numërim përpara dhe kombinim të dy sasive , e dallon mbledhjen në situata konkrete.</p> <p>E kupton zbritjen si numërim mbas dhe marrje e një sasive nga tjetra, e dallon zbritjen në situata konkrete.</p> <p>Mbledh/zbret numra njëshifror me numërim përpara / mbas.</p>	<p>Njoftimi me vargjet e numrave.</p> <p>Numëratore dhe kube.</p> <p>Domino.</p> <p>Domino.</p> <p>Lëvizje precize para dhe pas mbi katrorë ku janë shënuar numra.</p> <p>Nxënësit shpjegojnë si kanë ardhë deri te zgjidhja. Nxënësit të nxiten që së pari t'i gjejnë çiftet e numrave shuma e të</p>	<p>Varg të numrave- të madh Vargje të numrave – për çdo nxënës.</p> <p>Numëratore , kube , vargje me numra, mbulesë.</p> <p>.</p> <p>Komplet (set) i madh domino për punë për të gjithë nxënësit. Komplete të vogla për punë në grupe.</p> <p>Letra (karta) me numra 0-9 Domino set për çdo çift.</p> <p>Shirit ose vargje me numra për në dysheme , vargje të vogla me numra për çdo nxënës. Shirita të zbrazëta ose vargje.</p>	<p>Ndonjë nxënës mund të ketë nevojë për varg të numrave personal.</p> <p>Përdorimi i mjeteve dhe materialeve të njëjta në kontekst të ndryshëm.</p> <p>Mundësojuni nxënësve të fitojnë njohuri me vargje të zbrazëta dhe të shënuara me numra.</p>

<p>Mbledh tre numra njëshifror, prej të cilave shuma e dy prej tyre është 10, psh. $4 + 3 + 6 = 10 + 3$.</p> <p>E kupton dallimin nëpërmjet mbledhjes (edhe sa duhet deri....?).</p> <p>E gjen numrin për dy më të madh ose për dy më të vogël se një numër deri 20, duke e vërejtur kalimin në vargjet e numrave.</p>	<p>cilëve është 10.</p> <p>Formimi i çifteve: zgjedhni numër më të madh se 6. Hudhni kubin , tregoni numrin në vargun me numra, edhe sa duhet që të fitohet numri i zgjedhur?</p> <p>Kërcimi dhe kapërcimi i i vargut të numrave: Ndaluni te një numër ; kërceni para për dy, cili është numri i ri?</p>	<p>Numëratore të vogla.</p> <p>Vargje të numrave vertikale ose horizontale – të mëdha për tërë paralelen , të vogla për mbi bankë. Një kub të shënuar me numrat prej 1 deri në 6.</p> <p>Varg i madh me numra për tërë paralelen, më të vogla për mbi bankë.</p>	<p>Kjo fillimisht mund të bëhet në vargun e numrave në dysheme.</p>
---	--	--	---

Qëllimet e të mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Zgjidhja e problemeve</p> <p>Zbatimi i i njohurive në zgjidhjen e problemeve me numra dhe bashkimin e pjesëve në tërësi (enigma).</p> <p>Vendosë a do të përdorë mbledhje ose zbritje për zgjidhjen e ndonjë problemi të rëndomtë të shprehur gojarisht dhe e demonstroi duke përdorë sende.</p> <p>E verifikon (vërteton) përgjigjen e mbledhjes së numrave me renditje të ndryshme.</p> <p>E verifikon (vërteton) përgjigjen e detyrës me zbritje duke i mbledhë përgjigjen me numrin më të vogël.</p>	<p>“ Çka nëse “ aktivitete: Nëse ka 3 ëmbëlsira bëra edhe 3 dhe i hëngra 2. Sa mbetën?</p> <p>Tregimi i tregimeve: Arsimtari tregon tregim me sasi të panjohur: I poqa disa kuleç . qeni i hëngri 3, kurse ngelën 3. Sa kuleç bëra në fillim?</p>	<p>Shfrytëzimi i sendeve nga jeta e përditshme.</p> <p>Shfrytëzimi i sendeve nga jeta e përditshme.</p>	

1B: Gjeometria dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e të mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Format dhe të menduarit gjeometrik</p> <p>Emëron dhe ndan forma 2D të rëndomta (psh. rrethe, katrorë, drejtkëndësha, dhe trekëndësha) duke i dalluar sipas numrit të faqeve, sipas vijave të drejta dhe të lakuara. I shfrytëzon të bën shema dhe modele.</p> <p>Emëron dhe ndan forma 3D të rëndomta (psh. kubin, kuadrin, cilindrin, konin dhe topin) duke i dalluar sipas numrit të sipërfaqeve dhe sipas sipërfaqeve të rrafshëta ose të lakuara.</p> <p>E dallon vijën themelore të simetrisë.</p> <p>Zgjidhja e problemeve</p> <p>I dallon marrëdhëniet e thjeshta mes formave.</p>	<p>Shfrytëzimi i përmbledhjes së formave të rëndomta 2D: Zgjedhen shembuj nga nxënësit dhe përshkruhen. Zgjedhet shembull që përputhet me shembullin e vet, shembullin e caktuar nga arsimtari ose nga ndonjë nxënës tjetër.</p> <p>Identifikimi i formave të rëndomta në klasë.</p> <p>Klasifikimi i 3D formave sipas vetive.</p> <p>Zgjedhet shembull dhe përshkruhet.</p> <p>Përpilim i skemave dhe modeleve.</p> <p>Shfrytëzimi i pasqyrave që të bën dhe të përshkruan refleksion.</p> <p>Krahasimi dhe vërejtja e dallimit të karakteristikave për format 2D dhe 3D.</p>	<p>Forma të rrafshëta, forma të vizatuara.</p> <p>Forma të rëndomta.</p> <p>Pasqyra.</p> <p>Format, 2D dhe 3D.</p>	<p>Gjithashtu shfrytëzim i fotografive, modeleve, materialeve të ndryshme për ta treguar simetrinë në jetën reale.</p>

Njësia 1C : Matje dhe zgjidhje të problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Matje</p> <p>I dallon të gjitha monedhat.</p> <p>Llogaritë si duhet të pagohet shuma e njëjtë duke përdorë monedha më të vogla.</p> <p>Krahason gjatësi dhe peshë me krahasim direkt, pastaj me përdorim të njësive jostandarde të rëndomta.</p> <p>E vlerëson dhe krahason vëllimin me krahasim direkt, e pastaj me përdorim të njësive jostandarde të rëndomta.</p> <p>Përdorë gjuhë krahasuese, psh. më i gjatë, më i shkurtë, më i rëndë, më i lehtë.</p> <p>Fillon t'i kuptojë dhe t'i përdorë d</p>	<p>Gjetja e të gjitha monedhave me vlerë të njëjtë.</p> <p>Shkëmbim të monedhave me vlerë të caktuar me disa monedha me vlerë më të vogël.</p> <p>Mbledhja e vlerës së monedhave.</p> <p>Bëhen krahasime të drejtpërdrejta në kontekste të ndryshme: Gjatësia e dy fëmijëve; shfrytëzimi i baraspeshës për të zbuluar cila prej tri pjesëve është më e rëndë.</p> <p>Shfrytëzimi i enëve me madhësi të ndryshme për të zbuluar se cila nxe më shumë.</p> <p>Të kuptuarit dhe shfrytëzimi në situata të përditshme.</p>	<p>Monedha me vlerë të caktuar (të vërteta, jo plastike). Enë të vogla për t'i nda monedhat.</p> <p>Sende (mjete) për matje të peshës nëse është përkatëse.</p> <p>Ujë, rërë, oriz, thjerrëz (zmadhues) enë .</p> <p>Orë rërë, orë.</p>	<p>Realizoni aktivitetet sa më praktike që të zhvillohet të menduarit.</p> <p>Shfrytëzoni e vëzhgimin si instrument për notim.</p> <p>Realizoni aktivitetet sa më praktike që të zhvillohet të menduarit.</p> <p>Shfrytëzoni e vëzhgimin ssi instrument për notim.</p> <p>Kërkoni prej nxënësve ide tjera. Bëni zgjerim në 2 minuta ose 5 minuta. Përdorni vokabular për kohë psh. sot, nesër, dje.</p>

njësi të caktuara për kohë, psh. minutat, orët, ditët, javët, muajt dhe vitet.	Të kuptuarit dhe përdorimi i njësive për kohë në kontekst përkatës: Lidhshmëri me praktikën (rutinën) dhe aktivitetet e përditshme..Çka mundesh të bësh për një minutë., sa kërcime? Sa herë mundesh ta shkruash emrin tënd?		
--	---	--	--

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Zgjidhja e problemeve Zgjedh dhe shfrytëzon strategji adekuate për të llogaritur dhe e shpjegon procedurën.</p> <p>Zbatimi i njohurive në zgjidhjen e problemeve me numra dhe në bashkimin e pjesëve në tërësi (enigma)</p> <p>Bën vlerësim real për llogarinë dhe e kontrollon të njëjtën.</p>	<p>Shfrytëzoni strategji personale për zgjidhjen e problemeve me matje në kontekst të vetë klasës: psh. 6 sende i përgjigjen peshës të librit tim; 8 sende i përgjigjen peshës së këpucës time. Sa sende i përgjigjen peshës së dy këpucëve bashkë?</p> <p>Shkafi është i gjerë 2 metër .Tavolina është e gjerë 1 metër. Për sa është më i gjerë shkafi se tavolina? Zgjidhni shembuj tjerë në klasë për ti shpjeguar matjet. Unë harxhova “? “ në shitore .Miku im harxhoi “ ? “. Sa denarë harxhuam të dy?</p> <p>Numëroni disa monedha në enë, ja shtoni edhe 4. Sa është vlera e monedhave tani? Çka mundemi të blejmë me ato monedha?</p>	<p>Sende (mjete) për matje.</p> <p>Vegla për matje Monedha</p> <p>Monedha, enë, sende me çmime.</p>	<p>Nxitni diskutim për strategji. Kjo mundet të përdoret si vegël (instrument) për notim.</p> <p>Këto aktivitete duhet të jenë sa më shumë që është e mundur më praktike përpara se të fillojnë nxënësit të shkruajnë.</p>

2A: Numri dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Gjen numër për dy më të madh ose për dy më të vogël prej një numri deri në 20, duke e vërejt kalimin në vargun e numrave.</p> <p>E kupton mbledhjen si numërim përpara dhe kombinim të dy sasive, e dallon mbledhjen në situata konkrete.</p>	<p>Nxënësve shpërndaju letra (karta) me numra deri 20. Nxënësit duhet të punojnë në çifte. Cili numër është më u madh se “?”. Cili numër është për 2 më i vogël se “?”. Pas çdo pyetje të parashtruar, çifti që e ka atë numër e tregon letrën (kartën). Shëno përgjigjen te vargu i numrave.</p> <p>Trego vargun e numrave .Nxënësit i fshehin letrat e tyre.” Më tregoni një numër që është më i madh se 7 dhe më i vogël se 10. “ Çiftet që e kanë numrin e ngrenë. Loja vazhdon me shembuj tjerë.</p> <p>Nxënësve u tregohen letra (karta) me numra . Tregoi dikujt që e zgjidhni rastësisht “Cili është ai numër?” Zëvendësoni numrat me sende. Numëroni sendet dhe vendoni letrën (kartën) me atë numër afër tyre. “ Çka do të ndodhë nëse të dy grupet me sende do t'i bashkojmë. Numëroni sa sende ka gjithësej? “ Pastaj shënoni dhe sqaroni e aktivitetin me vargun e numrave.</p>	<p>Numëratore të vogla Letra (karta) me numra 0-20 Varg të madh me numra.</p>	<p>Çiftet e nxënësve mund formohen me nxënës me aftësi të ndryshme</p> <p>Kur e shënoni mbledhjen , shkruani çdo numër dhe shenjë ashtu si e shqiptoni që të mundën nxënësit ta vërejnë lidhjen në mes numrave dhe shenjave.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>E kupton zbritjen si numërim për mbas (prapa) dhe marrje të një sasive nga tjetra, e dallon zbritjen në situata konkrete.</p> <p>Fillon t'i dallon shenjat “ + “ , “ - “ dhe “ = “ në shprehje matematikore që kanë të bëjnë me mbledhje dhe zbritje.</p> <p>Tregon se cili numër është për 1 ose për 10 më i madh ose më i vogël prej cilit do numër prej 0 deri 30.</p> <p>E përdorë shenjën “ = “ për të treguar barazim.</p> <p>Fillon t'i zbërthen numrat dyshifror në dhjetëshe dhe njëshe dhe anasjelltas.</p>	<p>Demonstroni (tregoni) vargje me numra të mëdhenj dhe letra (karta) me numra prej 0 – 20. Numëroni prapa nëpër varg dhe karta nga pika të ndryshme të nisjes.</p> <p>Zëvendësoni letrat (kartat) me numra me sende të ndryshme.</p> <p>Zgjidhni një nga numrat dhe merreni 3, duke aluduar te vargu i numrave për ta treguar zbritjen (duke numëruar prapa).</p> <p>Përsëritni duke u nisur nga numra të ndryshëm .</p> <p>Nëse një herë nxënësit njoftohen me operacionet mbledhje zbritje , duhet të futen (zbatohen) shenjat për t'i zëvendësuar fjalitë e shprehura, duke i shkruar si fjalë përkatëse për të shprehurën.</p> <p>Nxënësvë t'u ndahen Letra (karta) me numra . Parashtroni pyetje si psh. “ Kush e ka letrën me numrin për 1 më të madh se 3 ? ” “ Kush e ka letrën me numrin që është për 10 më i madh se 3 ? “</p> <p>Duke shfrytëzuar peshore me dy</p>	<p>Vargje të mëdhenj me numra Letra (karta) me numra 0 – 20 Numëratore të vogla</p> <p>Komplet (set) të letrave (kartave) Prej 0 – 30 për të gjithë nxënësit.</p> <p>Peshore për drejtpeshim , sende (psh. kube të llojit të njëjtë)</p>	

	<p>tasa, dhe numër të njëjtë ose të ndryshëm të sendeve identike shpjegoni domethënien e shenjës “ = “ .</p> <p>Kupton dhe përdorë shifra njëshe dhe dhjetëshe në shembuj praktik.</p>	<p>Letra me numra, shigjeta,kube.</p>	<p>Arsimtari duhet të pozicionohet ashtu që të gjithë nxënësit ta shohin dhe të mjete për çiftet e nxënësve nëpër banka.</p>
--	--	---------------------------------------	--

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>E ndërlihdh numërimin përpara dhe pas nga dhjetë për të gjetur numra të cilat janë për 10 më të mëdhenj/ më të vegjël prej një numri të dhënë deri 100.</p> <p>Kupton se ndryshimi i radhitjes së mbledhësve nuk e ndryshon shumën.</p> <p>Mbledh çifte numrash deri 20 duke filluar nga numri më i madh vazhduar të numërojë.</p> <p>Fillon të mbledhë numër njëshifror me numër njëshifror dhe numër dyshifror me numër dyshifror deri 20.</p>	<p>Numërim gojor nga dhjetë duke filluar prej 0 . Numërim gojor nga dhjetë duke filluar prej 0, me referencë në tabelën “ qindëshe “. Numërim gojor të dhjetësheve nga një numër i dhënë, me referencë në tabelën “ qindëshe “</p> <p>Aktivitete me ndihmën e të cilave nxënësit do të kuptojnë se ndërrimi i radhitjes (i vendeve) të mbledhësve nuk e ndryshon shumën . Kjo tregohet edhe me vargjet e numrave.</p> <p>Me ndihmën e numëratores , shpjegoni mbledhjen si vazhdimësi duke filluar prej numrit më të madh.</p> <p>Përdorni kube ose letra (karta) me numra për të mbledhë numra njëshifror ose dyshifror me numër njëshifror.</p>	<p>Tabela “ qindëshe “</p> <p>Numëratores Shirita të numrave ose vargje të numrave .</p> <p>Llogaritëse, letra me numra (karta).</p> <p>Kube Letra me numra (karta).</p>	<p>Përdorni tabelë të madhe “ qindëshe “ që të kenë mundësi të gjithë nxënësit të shohin si dhe tabela të vogla “ qindëshe “</p>

<p>Zgjidhja e detyrave</p> <p>Zbatimi i njohurive në zgjidhjen e problemeve me numra dhe bashkim të pjesëve në tërësi (enigma)</p> <p>Gjen më shumë kombinime, psh. në sa mënyra mundet të radhiten tre sende të ndryshme .</p> <p>Vendosë të përdorë mbledhje apo zbritje për të zgjidhë një problem të thjeshtë të shprehur me gojë dhe e paraqet atë duke përdorë sende.</p> <p>E kontrollon përgjigjen me mbledhje të numrave me radhitje të ndryshme.</p> <p>E kontrollon përgjigjen e detyrës me zbritje , me mbledhje të përgjigjes me numrin më të vogël.</p> <p>Zgjedh dhe përdorë strategji përkatëse për llogaritje dhe sqaron procedurën.</p> <p>Vendosë a do të përdorë mbledhje ose zbritje për zgjidhjen e problemit të rëndomtë të shprehur gojarisht dhe e demonstroi atë duke përdorë sende.</p> <p>Bën vlerësim real të llogarisë dhe rezonon se a thua përgjigjja është e saktë.</p>	<p>“ Çka nëse “ dhe “ Çka mundemi të bëjmë më tej “</p> <p>Përdorimi i 3 kaushëve (kornet) për akullore, 3 toptha me ngjyrë të ndryshme – si mundet të radhiten në mënyra të ndryshme.</p> <p>Probleme të rëndomta nga jeta e përditshme.</p> <p>Mblidhen numra me renditje të ndryshme ku shfrytëzohen edhe mendimet (idetë) e nxënësve.</p> <p>Kontrolloni përgjigjet e detyrave nga zbritja duke i shfrytëzuar mendimet (idetë) e nxënësve.</p> <p>Jepu mundësi nxënësve të shfrytëzojnë strategji të ndryshme që ti zgjidhin detyrat dhe ta tregojnë mënyrën e zgjidhjes.</p> <p>Jepu mundësi nxënësve të shfrytëzojnë strategji të ndryshme për mbledhje dhe zbritje dhe ta shpjegojnë mënyrën e zgjidhjes duke përdorë sende.</p> <p>Diskutoni për strategjitë përkatëse.</p>	<p>Kub, domino, letra për hulumtim të shumave.</p> <p>Sende , fotografi të vizatuara me 3 sende me formë të njëjtë por të ndryshme sipas ngjyrës dhe madhësisë.</p> <p>Të gjitha materialet që ndihmojnë ta vizualizojnë problemin.</p>	<p>Nxënësit përdorin numëratore për të mbledhë ç’tetë numrave.</p>
---	---	---	--

2C: Punë me të dhëna dhe zgjidhje të problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Organizim, kategorizim dhe demonstrim të të dhënave</p> <p>Përgjigjet në pyetje me diferencim (ndarje) dhe organizim të të dhënave ose sendeve në mënyra të ndryshme psh., :</p> <ul style="list-style-type: none"> - me përdorim të grafikoneve dhe piktogrameve me sende praktike; - bisedë rreth rezultateve të paraqitura në lista dhe tabela me sende praktike; - bisedë për rezultatet e paraqitura në diagramin e Venit dhe Kerolovit më dhënie të kriterëve për grupim të sendeve të njëjta. 	<p>Kuptimi dhe përdorimi i fjalorit përkatës.</p> <p>Zgjidhja e problemeve psh., sa ruza mundem të mbaj në dorë ? Si mundemi ta zbulojmë? Si mundemi ti organizojmë informatat? Bëni dhe organizoni listë. Mblidhni të dhëna dhe bëni tabelë.</p> <p>Parashtroni pyetje për ta zbuluar ushqimin e preferuar. Paraqiteni në diagram në formë të shtyllës ose piktogram.</p>	<p>Trego letra (karta) me fotografi të sendeve.</p> <p>Çdo mjet ndihmës që mundëson paraqitje të informatave: kube për lidhshmëri fotografi, vizatime etj.</p>	
<p>Zgjidhja e problemeve</p> <p>Zgjedh dhe shfrytëzon strategji përkatëse për llogaritje dhe e shpjegon procedurën.</p>	<p>Zgjidhja e problemeve me grumbullim ,renditje (rregullim) dhe organizim të të dhënave. Pastaj të dhënat paraqiten me vizatim , me vendosje të sendeve ose fotografi në tabelën e vizatuar.</p>	<p>Të gjithë materialet që mundësojnë tregim të të dhënave.</p>	<p>Nxënësve duhet tu mundësohet të bëjnë zgjedhje se si do t'i paraqesin të dhënat e tyre.</p>

2C: Matja dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Paratë</p> <p>I njeh të gjitha monedhat.</p> <p>Llogarit si duhet paguar shuma e saktë me monedha të vogla.</p> <p>Gjatësia, masa dhe vëllimi</p> <p>Krahason gjatësitë dhe peshat me krahasim të drejtpërdrejtë, pastaj i shfrytëzon njësitë e masave të rëndomta jostandarde psh. pëllëmbën.</p> <p>Vlerëson dhe krahason vëllimin me krahasim të drejtpërdrejtë, e pastaj me përdorimin e njësive të masave jostandarde.</p> <p>Shfrytëzon gjuhën krahasuese, psh. Më e gjatë, më e shkurtë, më e rëndë, më e lehtë.</p> <p>Koha</p> <p>Fillon ti kuptojë dhe ti përdorë njësitë e ndryshme për matjen e kohës, psh. minutat, orët, ditët, muajt, vitet.</p>	<p>I dallon të gjitha monedhat</p> <p>I shkëmben të gjitha monedhat me vlerë të njëjtë</p> <p>Mbledh vlerën e monedhave.</p> <p>Kuptojeni dhe shfrytëzoni fjalorin lidhur me gjatësinë, masën dhe vëllimin</p> <p>Bëni krahasim të drejtpërdrejtë (pa mbledhje) në situata praktike.</p> <p>Shfrytëzoni njësi të masave të rëndomta jostandarde dhe standarde, numëroni dhe zgjidhni probleme në situata të ndryshme praktike.</p> <p>Gjatë krahasimit të gjësendeve në situata praktike përdor shprehje përkatëse.</p> <p>Radhitni me radhë ditët e javës, muajt e vitit. Mësoni që 1 javë ka 7 ditë.</p> <p>Një ditë ka 24 orë.</p> <p>Vlerësojeni dhe kontrolloni.</p>	<p>Monedhat</p> <p>Shiriti, gjëra të lehta dhe të rënda, gota të mëdha dhe të lehta e të tjera.</p> <p>Peshore, gjëra për të matur, gota për mbushje e tjera.</p> <p>Gjësende, foto të gjësendeve.</p> <p>Lloje të ndryshme orësh psh orë muri , orë me rërë, orë dore, orë xhepi .</p>	<p>Përdorimi i parave të vërteta duhet i nxitur me qëllim që të vërehet të menduarit e nxënësve.</p> <p>Tregoni foto për ata nxënës që kanë vështirësi gjatë të shprehurit me gojë.</p> <p>Tregoni foto për ata nxënës që kanë vështirësi gjatë të shprehurit me gojë.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>E lexon kohën (orën) dhe i din kohët kryesore të ditës (, mëngjesin, mbasditen, mbrëmjen).</p> <p>I radhit ditët e javës dhe ngjarjet e tjera.</p> <p>Zgjidhja e problemeve</p> <p>Zgjedh dhe shfrytëzon strategji përkatëse për llogaritje dhe e sqaron procedurën (mënyrën se si e ka zgjidhur)</p> <p>Zbaton dituritë në zgjidhjen e problemeve me numra dhe radhitjen e pjesëve në tërësi (enigma)</p>	<p>Radhit ngjarjet që ndodhin gjatë ditës, javës ose radhit pjesët e tregimit.</p> <p>Arsimtari parashtron pyetje si psh.:</p> <p>Sa orë ka prej orës 3 deri në ora 5?</p> <p>Tani është ora 6. Sa do të jetë ora pas 4 orëve?</p>	<p>Orë.</p> <p>Orë.</p>	<p>Shfrytëzohen orë me shigjeta që nxënësit vetë ti lëvizin shigjetat.</p>

3A: Numri dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>E kupton mbledhjen si numërim përpara dhe kombinim të dy sasive, e dallon mbledhjen në situata konkrete.</p> <p>E kupton zbritjen si numërim mbrapa dhe zbritje e një sasive nga tjetra, e dallon zbritjen në situata konkrete.</p>	<p>Tregoni letrat (karta) me numra. Zgjedh (merr) njërën në mënyrë rastësore. „, Cili është ai numër;? Ndërroni numrat me gjësende. Numëroni dhe vendoseni letrën me numër afër tyre.</p> <p>Tregoni në tabelën „ qindëshe,, si janë renditur në mënyra të ndryshme vargjet e numrave, si dhe mënyra të mundshme kur punohet me numra më të mëdhenj.</p> <p>Çka nëse fillohet nga 7 dhe numërojmë 5 përpara. Ku do të përfundojmë?</p> <p>Përdorni numra të ndryshëm në fillim.</p> <p>Sa është shuma e dy grupeve të sendeve? Shenoni dhe thuaje me me gojë aktivitetin. Shënoni atë që thatë!</p> <p>Tregoju vargun me numra të mëdhenj dhe karta me numra prej 0-50. Numëroni mbrapa në varg dhe në karta duke u nisur nga numra të ndryshëm. Zëvendësoni kartat me numra me sende të tjera. Zbritni 3, duke treguar kah vargu me numra që të tregoni zbritjen(duke numëruar mbrapa). Përsëriteni me numra të ndryshëm që ta kuptojnë zbritjen.</p>	<p>Karta (letra) me numra 0-50. Tabela „qindëshe,,. Numëratore të vogla.</p> <p>Varg i gjatë me numra. Karta me numra 0-50. Numëratore të vogla.</p>	<p>Disa nga nxënësit do të kenë nevojë të punojnë me katrorin e tyre prej 100 në banka ose të ulur në dysheme.</p>

<p>Fillon të dallojë shenjat „ + , „-„ dhe „=„ treguesit matematikor që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe zbritjen. E përdor shenjën „=„ për të treguar se janë të njëjta.</p> <p>Fillon ti zbërthej numrat dy shifrorë në dhjetëshe dhe njëshe dhe anasjelltas.</p> <p>Kupton se ndërrimi i vendeve të mbledhëseve nuk e ndryshon shumën.</p>	<p>Tregoni në tabelën „qindëshe„,se si vargjet janë radhitur në mënyra të ndryshme, si mënyra të mundshme në rastet kur punohet me numra të mëdhenj. Fillojmë nga numri 17 dhe numërojmë mbrapa. Ku do të përfundojmë?</p> <p>Shënoni treguesit matematikorë që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe zbritjen. Më shumë punoni me gjithë paralelen, sesa në çifte dhe individualisht.</p> <p>Kupton dhe përdor shifra njëshe dhe dhjetëshe gjatë shembujve konkret.</p> <p>Aktivitete që do ju ndihmojnë nxënësve të kuptojnë se ndërrimi i renditjes së mbledhësve nuk e ndryshon shumën. Kjo u tregohet edhe në vargun me numra.</p>	<p>Karta me numra të mëdhenj dhe shenja. Numëratore.</p> <p>Karta (letra) me numra, shigjeta dhe kube.</p> <p>Shirita me numra</p> <p>Varg me numra. Numëratore.</p>	<p>Përdorni set të madh për punë së bashku me nxënësit e klasës dhe jepni secilit fëmijë ose çift fëmijësh setin për punë që të punojnë nëpër banka. Për disa nxënës mund të jetë e rëndësishme të jenë të ngjyrosura njëshet dhe dhjetëshet.</p> <p>Përdorni numëratore për numërim dhe mbledhje para se të lëvizë shiriti/ vargu me numra.</p>
---	--	--	--

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Mbledh numra çift deri më 20 duke filluar prej numrit më të madh me vazhdim të numërimit.</p> <p>Fillon të mbledh numra një shifror me numra njëshifror dhe numra dyshifror me numra njëshifror deri më 20.</p> <p>I dallon gjysmën e numrave çift deri më 10, përgjysmon forma me palosjen e letrës dhe i dallon cilat forma janë përgjysmuar.</p>	<p>Me ndihmën e numëratores, shpjegoni mbledhjen si vazhdimësi duke filluar nga numri më i madh.</p> <p>Shfrytëzoni kube ose karta (letra) me numra për mbledhje të numrave njëshifror ose numra dyshifror me numra njëshifror.</p> <p>Në mënyrë praktike i shfrytëzoni fjalët „ e tërë,, dhe „ gjysma,, (Shfrytëzoni sasi të vogla të gjërave (një grusht) dhe ndajeni në pjesë të barabarta(në gjysmë). Diskutoni për rezultatet që i keni fituar dhe ua tregoni shembujt ku gjatë përgjysmimit ka mbetje.</p> <p>Thuaje gjysmën e një numri çift deri më 10.</p>	<p>Numëratore.</p> <p>.</p> <p>Numëratore.</p> <p>Shirit me numra ose vargu me numra.</p> <p>Tabela,,qindëshe,,</p> <p>Numëratore. Karta (letra) me numra</p>	

Qëllimet e mësimit)	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	- Komentet
<p>Fillon ti shfrytëzohë numrat çift shuma e të cilëve është 10 gjatë mbledhjes dhe zbritjes me kalim deri më 20 (psh. që të mbledh 8+3, në 8 shton 2, pastaj shton edhe 1)</p> <p>I përdor dituritë për mbledhje të mbledhësve të njëjtë, gjatë mbledhjes së dy mbledhësve të ndryshëm, psh. 5 + 6.</p> <p>E njëj (dallon) përdorimin e shenjës <input type="checkbox"/> vendin e numrit të panjohur gjatë mbledhjes/zbritjes, psh. $6 + \square = 10$; $10 - \square = 6$</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <p>E dyfishon cilin do numër njëshifror.</p> <p>Gjen gjysmën e çifteve të gjësendeve deri më 10.</p> <p>Mundohet të ndajë numrat deri më 10 që të vërtetoj cilët numra janë çift dhe cilët janë tek.</p>	<p>Filloni të mblidhni numra çift njëshifror shuma e të cilëve është 10. Përdorni 2 hapa dhe kaloni mbi 10 si fazë e mesme psh. ($4+8= 12$ ose $4+6+2 =10+2= 12$). Përdorni numra të ndryshëm. Përdorni shembuj edhe nga zbritja. $5+6= 11$. Kjo mund të tregohet edhe si 5 e dyfishtë. (psh: $(5+5)$ plus 1, ose dy 6-të minus 1. Përdorni shembuj të ndryshëm.</p> <p>Shfrytëzoni njohuritë paraprake të nxënësve për mbledhje/zbritje për ta zbuluar numrin e panjohur. Përpiloni detyra të ndryshme ku mungon ndonjë numër në pozicione të ndryshme.</p> <p>Kuptimi i nocioneve „gjysma,, dhe „dyfishimi,,</p> <p>Numëroni 10 sende. Ndajeni në dy pjesë të barabarta. Numëroni çdo pjesë. Bëni kombinime me numra të tjerë.</p> <p>Numëroni 10 sende. Ndajeni në dy gjysma të njëjta. Kombinoni sërish me numra tek dhe bisedoni lidhur me mbetjet. Çka po ndodh? Ju ka mbetur diçka? Përsëritni disa herë që ti përfshini të gjithë numrat prej 1-10. Shënoni ata numra që u kanë mbetur pa mbetje dhe ata me mbetje.</p>	<p>1-6 kube, 7-12 kube, karat me numra për nivelet përkatëse.</p> <p>Numëratore.</p> <p>Tabela „qindëshe,,</p> <p>Sllajde me shirit të numrave.</p> <p>Numëratore.</p> <p>Vargu i numrave.</p> <p>Tabela „qindëshe,, Llogaritëse deri më 10</p> <p>Numëratore.</p> <p>Tabela „qindëshe,, Vargu i numrave.</p> <p>Sllajde me shirit të numrave.</p>	<p>Kjo mund të jetë më e rëndë për disa nxënës të cilëve u nevojitet më tepër kohë.</p> <p>Lista me mbledhës të njëjtë mund të jetë e dobishme për disa nxënës.</p> <p>Shirit me karta me numra, i shkruar horizontalisht për llogaritje. Përmbi shirit lëviz shkop (vizore) i cili do ta mbulojë sa herë që del numri i panjohur.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>I ndan sendet në dy grupe të barabarta.</p> <p>Zgjidhja e problemeve Zbatimi i njohurive gjatë zgjidhjes së problemeve me numra dhe bashkimin i pjesëve në tërësi (enigma). E kontrollon përgjigjen e detyrës me mbledhjen e numrave me renditje të ndryshme. E kontrollon përgjigjen e detyrës me zbritje , me mbledhjen e përgjigjes dhe numrit më të vogël. E sqaron dhe vazhdon të numëroj në varg nga dhjetë përpara dhe mbrapa psh. 90,80,70. I njeh marrëdhëniet e rëndomta në mes numrave, psh ky numër është për dhjetë më i madh nga se tjetri.</p>	<p>Shfrytëzoni probleme me „tregime,, Kam 4 ëmbëlsira që ti ndaj me shokun tim. Para se të fillojmë për ti ngrënë erdhi edhe një shok. Sa ëmbëlsira të tëra do të kishin te dy shokët para se të vij shoku tjetër? Sa ëmbëlsira të tëra kishin pasi erdhi shoku ? Sa mbeten? Tregimin ndërrojeni me numra deri në 10. Shfrytëzoni tregime ose përvoja nga përditshmëria ku ka situata të mbledhjes dhe zbritjes.</p> <p>Për vazhdimin e vargut të numrave nga dhjetë përpara dhe mbrapa mund të përdoret tabela „qindëshe,,</p>	<p>Numëratore deri në 10.</p> <p>Libra me tregime.</p> <p>Numëratore.</p> <p>Tabela „ qindëshe,,</p> <p>Vargu me numra</p> <p>Tabela „ qindëshe,,</p>	

3B: Puna me të dhëna dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Organizimi, kategorizimi dhe paraqitja e të dhënave</p> <p>Përgjigjet në pyetje me ndarje dhe me organizim të dhënave ose me ndarjen e gjësendeve në mënyra të ndryshme, psh.</p> <p>Me shfrytëzim të diagramit ose piktogramit me mjete konkrete.</p> <ul style="list-style-type: none"> - bisedë për rezultatet e dhëna në fleta ose tabela me mjete praktike. - Bisedë për rezultatet e diagramit të Venit dhe Kerolit duke dhënë kritere të ndryshme për grupimin e tyre. 	<p>Përdor pyetje nga j përditshmëria: Çka dëshiron të bësh? Si mund ta zbulojmë? Si mund ti organizojmë të dhënat? Bëni një diagram në formë të shtyllës.</p> <p>Klasifikoni numrat dhe organizoni nëpër fleta ose tabela:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të gjithë numrat çift deri më 30 • të gjithë numrat tek deri në 50, • 6 numra më të mëdhenj se 10, por më të vegjël se 30 <p>Përdorni diagramin për treguar të dhënat e mbledhura. Filloni nga e njohura.</p>	<p>Çfarëdo mjeti që mundëson burimin e informacionit: Kubet që lidhen njëra me tjetrën, fotografi etj.</p>	
<p>Zgjidhja e problemeve</p> <p>Zgjedhë dhe përdorë strategji përkatëse për llogaritje dhe e sqaron mënyrën se si e ka zgjidhur.</p>	<p>Zgjidhë probleme me mbledhjen, radhitjen dhe organizimin e të dhënave. Pastaj, të dhënat paraqiten me vizatime, gjësendet ose fotot të vendosen në tabelën e vizatuar.</p>	<p>Të gjitha materialet që mundësojnë pasqyrim të të dhënave.</p>	<p>Nxënësve duhet tu mundësohet të bëjnë zgjedhje se si do ti paraqesin të dhënat.</p>

3C: Matja dhe zgjidhja e problemeve

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Parat</p> <p>I njeh te gjitha monedhat.</p> <p>Llogarit si të paguhet shuma e saktë duke i shfrytëzuar monedhat.</p> <p>Gjatësia, masat dhe vëllimi</p> <p>Krahason gjatësitë dhe peshat me krahasim të drejtpërdrejtë, pastaj me shfrytëzimin e njësive të rëndomta jostandarde.</p> <p>Vlerëson dhe krahason vëllimin me krahasim të drejtpërdrejtë dhe pastaj me shfrytëzimin e njësive jostandarde.</p> <p>Përdor gjuhën krahasuese, psh. më e gjatë, më e shkurtër, më e rëndë, më e lehtë.</p>	<p>Njihni të gjitha monedhat. Zëvendësoni monedhat me vlerë të njëjtë.</p> <p>Mblidhni monedha.</p> <p>Në sa mënyra të ndryshme mund të paguhet një gjësend?</p> <p>Të kuptojë dhe të shfrytëzojë fjalorin lidhur me gjerësinë, masën dhe vëllimin.</p> <p>Bëni krahasimin e drejtpërdrejtë (pa mbledhje) në situata konkrete.</p> <p>Përdorni masa të rëndomta standarde dhe jostandarde.</p> <p>Gjatë situatave krahasuese praktike të gjësendeve përdorin shprehjet përkatëse.</p>	<p>Monedhat</p> <p>Shirit, me gjësende të rënda e të lehta, gota të mëdha të vogla e tjera.</p> <p>Peshore, gjësende për matje, gota për mbushje e tjera.</p>	

<p>Koha</p> <p>Fillon të kuptojë dhe t'i përdorë pjesë të caktuara të njësive të kohës, si p.sh.minutat, orët, ditët, javët, muajt dhe vitet.</p> <p>E lexon kohën (orën) dhe i din pjesët kryesore të ditës.</p> <p>I radhit ditët e javës dhe gjërat e tjera të njohura.</p> <p>Zgjidhja e problemeve Zgjedh dhe shfrytëzon strategji përkatëse për zhvendosje (bartje) dhe e sqaron mënyrën se si e ka vepruar.</p> <p>I zbaton dituritë në zgjidhjen e problemeve me numra si dhe bashkimin e pjesëve në tërësi (enigmave)</p>	<p>Radhiti sipas radhës ditë e javës, muajt e vitit. Mësoni se 1 javë ka 7 ditë. Një ditë ka 24 orë.</p> <p>Kontrolloni dhe vlerësoni.</p> <p>Radhitje e ngjarjeve të njohura gjatë ditës, javës ose pjesëve të tregimit</p> <p>Jepni shembuj praktik për masat. Çfarë do të mund të shfrytëzoni?</p> <p>Si do ta përshkruani atë? Si e dini? Çfarë mendoni? A do të jetë çdoherë njëjtë?</p>	<p>Orët prej rëra.</p>	<p>Lidhshmëria me aktivitete praktike, pyetjet ju mundësojnë nxënësve që ti zhvillojnë aftësitë për të menduar dhe për të sjellur perfundime .</p>
--	---	------------------------	--

3. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve

KONTROLLI DIAGNOSTIK DHE VLERËSIMI

Në fillim të vitit shkollor mësuesi bën kontrollin diagnostik për të konstatuar zhvillimin dhe nevojat individuale të çdo nxënësi në mënyrë që të bëjë planifikim cilësor për realizimin e aktiviteteve të ardhshme. Me anë të këtij kontrolli konstatohet shkalla e paranjohurive, niveli i socilaizimit, zhvillimi emocional dhe fizik.

VLERËSIMI FORMATIV –

Gjatë zhvillimit të mësimit të lëndës së matematikës në klasën e parë parashikohet vlerësimi formativ i cili përfshin përpilimin dhe mbajtjen e portfolios së nxënësit ky hyjnë:

- mbledhja e të dhënave (punimeve, krijimeve, dëshmime, përgjigjeve etj) për secilin nxënë;
- listat e vlerësimit të vazhdueshëm (formativ) të përgatitura prej më parë që i plotëson mësuesi pasi bën nxënësi ndonjë aktivitete konkret që mund të jetë i veçantë (pozitiv ose negativ) ose mund të jetë studim i rastit ku mësuesi shënon gjendjen faktike të nxënësit;

Instrumentet që kanë të bëjnë me secilën fushë programore ku mësuesi fut të dhënat për të arriturat e nxënësit në të gjitha aspektet e zhvillimit (kognitiv - intelektual, socio- emocional, social dhe psikomotorik).

- Listat e vlerësimit në radhë të pare duhet të përfshijë objektivat (qëllimet) që duhet të arrihen kur e kryen klasën e pare dhe që nuk i përkasin klasave në vijim.

VLERËSIMI MIKROSUMATIV

Në fund të tremujorit të dytë, në bazë të të dhënave të grumbulluara, nëpërmjet vlerësimit formativ bëhet vlerësimi mikrosumativ.

VLERËSIMI SUMATIV

Duke u mbështetur në të dhënat e përgjithshme, të përfituara nga përcjellja dhe vlerësimi formativ, mësuesi e konstaton (përshkruan shkallën e zhvillimit dhe të arriturave të çdo nxënësi veçmas për çdo fushë programore.

ARRITSHMERITE DHE KALUESHMERIA E PERMBLEDHJEVE TE DESHMIVE

Gjatë gjithë vitit shkollor prindërit duhet të kenë qasje në të dhënat e përmbledhura (portfolion) e fëmijës së vet, që të mund të japin ndihmesën e tyre lidhur me realizimin më cilësor të mësimit të matematikës.

Nota përfundimtare analitike me shkrim i jepet po kështu prindërve dhe bëhet pjesë përbërëse e dhënave të përmbledhura të nxënësit.

Të dhënat e përmbledhura të nxënësit të selektuara dhe me të dhënat konkrete lidhur me të arriturat dhe vështirësitë e nxënësit përcillet më tej në klasat më të larta.

MËNYRAT PËR KONTROLLIM DHE VLERËSIM

Në mbështetje të kërkesave programore të lëndës së matematikës për klasën e pare, kontrollimi dhe vlerësimi, duhet të bëhen me ***gojë, në mënyrë praktike, me anë të prezantimeve dhe ushtrimeve dhe aktiviteteve përkatëse të përshtatshme për këtë moshë.***

4. Kushtet hapësinore për realizimin e programit mësimor

Sa i përket kushteve hapësinore për realizimin e programit ai bazohet në Normativin për hapësirën e klasës së I, II dhe III dhe mjetet mësimore të caktuar nga ana e ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

5. Normativi për kuadrin arsimor

Punën edukativo- arsimore për lëndën e matematikës në klasën e parë mund ta realizojë personi i cili ka mbaruar:

- profesor për grupin klasor;
- profesor për edukimin parashkollor;
-
- Pedagog i diplomuar.

Data dhe vendimi i sjelljes së programit mësimor

Programi mësimor për lëndën Matematika për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar, marrë dhe e lejuar nga Qendra ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination) dhe e adaptuar nga ana e Byrosë së zhvillimit të arsimit, e verifikuar me datë

Ministër

Spiro Ristovski